



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI GJASHTË MUJOR I PËRMBUSHJES SË CAQEVE

VLERËSIMI I PËRMBUSHJES SË CAQEVE TË KRU`ve TË PËRCAKTUARA NGA
ARRU PËR GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2016 NGA PROCESI
RREGULATOR I TARIFAVE 2015-2017

Periudha reportuese: Janar – Qershori 2016

DFTRR/ARRU

Prishtinë, Tetor 2016

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Misioni

“Regullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

PËRMBAJTA

KAPITULLI 1

QASJA DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

1	Parathënie	6
2	Sfidimi i biznes planeve rregullatore	7
3	Aplikimi i inflacionit	8
4	Metodologjia e vlerësimit të caqeve	9

KAPITULLI 2

ANALIZA E PËRMBUSHJES SË CAQEVE

1.	Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët	11
5.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve.....	12
2.	Analiza e shpenzimeve operative	14
6. 1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza.....	15
6. 2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza	16
3.	SHUMAT E FaturimiT dhe arkëtimi në vlerë monetare	17
7.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujérave të zeza.....	18
7.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza.....	19
7.3.	Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujérave të zeza	20
7.4.	Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza	21
4.	Investimet kapitale	22
8.1.	Shumat e investimeve kapitale nga financimet vetanake.....	23
8.2.	Paraqitja grafike e të dhënavë për investime kapitale vetanake të kompanive	26
8.3.	Shumat e investimeve kapitale të finançuara nga donatorët	27
8.4.	Paraqitja grafike e të dhënavë për investimet kapitale nga donatorët	30

KAPITULLI 3

ANALİZË KRAHASUESE E KRU-VE

1.	Analiza e humbjeve të ujit	32
2.	Sasia e ujit e cila kthehet në para	33
3.	Shpenzimet e pagave dhe të energjisë elektrike.....	34
4.	Mbulimi i shpenzimeve operative dhe investimeve kapitale vetanake nga shuma e arkëtimit	35

KAPITULLI 4

RANGIMI I KRU-VE

1.	Rangimi i KRU-ve sipas realizimit të caqeve	37
1.1	Rangimi individual sipas kriterit të përmbushjes së caqeve	39
1.2	Rangimi i KRU-ve sipas performances më të mirë të përmbushjes së caqeve	46
2.	Konkluzionet e raportit.....	47

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BPRR	Biznes Plane Rregullatore
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
FE	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Bifurkacioni" sh. a – Ferizaj
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Radoniqi" sh. a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidromorava" sh. a – Gjilan
MIT	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë
PE	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" sh. a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" sh. a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidroregjioni-Jugor" sh. a – Prizren
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve

KAPITULLI 1

QASJA DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

1 PARATHËNIE

Sipas praktikave të mira të përvetësuar nga ARRU edhe kësaj radhe kemi kënaqësinë të paraqesim para jush reportin gjashtë mujor të vitit 2016 me vlerësimin e shkallës së përbushjes së caqeve, të procesit rregulatorë të tarifave afatmesme 2015-2017. Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së veçantë të shtatë (7) kompanive regionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të cilën vlerësohet shkalla e përbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregulatorë te tarifave për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Për t'u përpiluar ky raport, fillimi shtjanë marrë të dhënat e aprovua nga procesi tarifor 2015-2017, për gjashtë mujorin e vitit 2016, të cilat njëkohësisht paraqesin të dhënat bazë përmes të cilave vlerësohet afarizmi i të gjitha KRU-ve në Kosovë. Më pastaj, janë paraqitur të dhënat e realizuara nga KRU-të për të njëjtën periudhë kohore të vitit 2016 për krahasim me të dhënat e aprovuara nga ARRU. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në sektor, në këtë raport janë paraqitur edhe të dhënat historike të cilat kanë ndodhur në gjashtë mujorin e vitit 2015 .

Qëllimi i këtij rapporti është:

- (i) Të jepet informacion për shkallen e arritshmërisë së treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për përudhën e shikuar kohore të vitit 2016.
- (ii) Krahasimi i treguesve të KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tarifor të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangjeve t'u mundësohet KRU-ve të ndërmarrin veprime të duhura me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendet e tillë deri në përfundim të vitit 2016 nga procesi rregulatorë i tarifave 2015-2017.

Duke pasur parasysh se KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë, vepron në kushte të veçanta të operimit, pasi që ofron ujë të trajtuar me shumicë për pjesën Veriore të këtij qyteti, të dhënat e kësaj kompanie pasqyrohen për gjithë regionin me të gjitha shërbimet që i ofron kjo kompani, duke i përfshi edhe shërbimet e furnizimit me ujë të trajtuar me shumicë të pjesës Veriore të Qytetit të tyre.

2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

Parimi bazë i procesit rregulatorë të tarifave të periudhës tarifore 2015-2017 është krijimi i parakushteve për një qëndrueshmëri ma të mirë financiare për kompanitë, që nënkuption; kosto optimale operative për sasi dhe cilësi të caktuar shërbimi për konsumatorët e shërbyer, të cilat kemi shpresuar dhe shpresojmë se do të arrihen me tarifa të arsyeshme të cilat janë të përballueshme për t'u paguar nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer, sikurse që kemi përcaktuar edhe caqe sfiduese për përmirësim të përfomancës së përgjithshme të tyre, dhe atë:

1. ARRU, mendon se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritet pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i përafrojnë me kostot mesatare të sektorit.
2. Ne, besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale të ujit, shumë kyçje të pa ligjshme dhe faturim jo të kënaqshëm, të cilat duhet të jenë në fokus të menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relacione optimale.
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar ngadalë , vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdeshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregulatorë 2015-2017.

Prandaj, ARRU do të kryej monitorimin e rregullt gjatë gjithë periudhës së mbetur tarifore 2016-2017 për të vlerësuar shkallën e përbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregulator, siç po bëjmë edhe me këtë raport dhe për rishikime eventuale të politikave të ardhshme tarifore.

3 APLIKIMI I INFLACIONIT

ASK e llogarit Indeksin e Çmimeve të Konsumit duke grumbulluar informacion të çmimeve për artikuj të ndryshëm në të gjithë territorin e vendit. Si i tillë inflacioni paraqet një rritje/zbritje ngulmuese e çmimit të të mirave dhe shërbimeve shkaktuar nga një sasi e vogël e të mirave materiale në treg dhe e një sasie të madhe të parasë në qarkullim.

ARRU i kushton kujdes të veçantë aplikimit të inflacionit në të dhënat financiare të KRU-ve të dorëzuara përgjatë procesit tarifor, pasi që qëllimi i këtij reporti kryesisht ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2015-2017, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, dhe për të qenë vlerësimi sa më real, të dhënat financiare të aprovuara nga ARRU të paraqitura në tabelat e mëposhtme janë të përshtatura me Indeksin e Çmimeve të Konsumit në Kosovë.

Duhet theksuar se, të dhënat financiare të aprovuara për jashtë mujorin e parë të vitit 2016 kanë marrë për bazë çmimet e mesit të vitit 2014 (Qershor 2014 = kur IÇKK-ja ishte 127.3), ngase BPRR për procesin tarifor 2015-2017 janë dorëzuara gjatë asaj kohe, të cilat gjatë procesit të përcaktimit të tarifave të vitit 2016 janë indeksuar me Indeksin e Konsumit të Çmimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të sqaruar ne paragrafin 4 të kësaj pjese.

Për këtë, të dhënat financiare të aprovuara nga ARRU ndryshojnë prej të dhënavë financiare që gjenden në BPRR-ët e KRU-ve, por të njëjtat janë të njoftuara në detaje me shumat e tillë financiare pas indeksimit, pasi që të gjitha kompanitë individualisht i kanë marr raportet përmbyllëse tarifore të vitit 2015-2017. Dallimet e evidentuara të dy periudhave janë të vogla në vlera absolute, por të njëjtat janë pasqyruar për shkak të korrektesisë së llogaritjeve dhe raportimit të saktë.

Të dhënat financiare të aprovuara, në këtë raport, kanë marrë për bazë të dhënat e BPRR-ve duke i shumëzuar me IÇKK 0.99673. Ky indeks është fituar duke pjesëtuar mesataren e IÇKK-së të vitit 2015 (126.883) me IÇKK-ën e mesit të vitit 2014 (127.3).

Sikurse edhe u theksua më lartë qëllimi i këtij reporti ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2015-2017 gjatë vitit 2015.

4 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2015-2017 për vitin 2015, ka qenë e njashme uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënavët të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabelë përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënavët, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015,
- të dhënat e aprovuara nga ARRU për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016,
- të dhënat e realizuara nga KRU për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016,
- përqindja krahasuese e gjashtë mujorit të parë 2016 me periudhën e njëjtë të vitit 2015,
- përqindja krahasuese e realizimit të cakut të vitit 2015, dhe
- vlerësimi përfundimtar.

Përqindja krahasuese për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 me periudhën e njëjtë kohore të gjashtë mujorit të parë të vitit 2015 është raporti i të dhënavët të dala nga treguesit e arritur të periudhave të shikuara dhe të shumëzuar me 100.

Përqindja krahasuese e realizmit të cakut për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 del si rezultat i raportit të dhënavët të aprovuara me të dhënat e realizuara dhe të shumëzuar me 100.

Vlerësimi përfundimtar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësim i ARRU-së, dhe identifikohet si:

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat e ujit të humbur dhe shpenzimeve operative në m³.

Kufijtë	Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
< 98.00 %	T P	Tejkaluar pozitivisht plus	Pozitiv +
98.00% - 102.00%	R	E realizuar	Pozitiv
102.01% - 106.00%	P	E përafruar	Negativ
> 106.00%	Jo e R	Jo e Realizuar	Negativ -
	E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat tjera

Kufijtë	Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
> 102.00 %	T P	Tejkaluar pozitivisht plus	Pozitiv +
98.01% – 102.00%	R	E realizuar	Pozitiv
94.00% – 98.00%	P	E përafruar	Negativ
<94.00%	Jo e R	Jo e Realizuar	Negativ -
	E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

KAPITULLI 2

ANALIZA E PËRMBUSHJES SË CAQEVE

1. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT

Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve prej nga është bërë krahasimi i të dhënave të realizuara me ato historike si dhe të dhënave të realizuara me të dhënat e aprovuara, me të cilat njëherit bëhet edhe vlerësimi i përmbytjes së caqeve.


Tabela Nr. 1. Krahasimi i të dhënave të aprovuara për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 me të dhënat e realizuara për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 dhe të dhënat historike për periudhën e njëjtë të vitit 2015.

Emri i Kompanisë	Të dhënat operative	Njësie matëse	Historike 6m 2015	Aprovuara 6m 2016	Realizuara nga KRU-të 6m 2016	% krahasuese 6m2015/6m 2016	% real cak 6m 2016	Vlerësimi për 6m 2016
Prishtina (PR)	Uji i prodhuar	m ³	20,446,562	22,216,942	22,248,615	108.81%	100.14%	R
	Uji i humbur	m ³	10,405,997	9,696,694	11,649,237	111.95%	120.14%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	10,040,565	12,520,248	10,599,378	105.57%	84.66%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	110,216	110,785	116,799	105.97%	105.43%	TP
Hidroregjioni Jugor (PZ)	Uji i prodhuar	m ³	8,227,791	10,566,627	8,289,217	100.75%	78.45%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	4,749,765	5,840,211	4,770,642	100.44%	81.69%	TP
	Uji i faturuar	m ³	3,478,026	4,726,416	3,518,575	101.17%	74.44%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	41,609	45,639	43,523	104.60%	95.36%	P
Hidrodrini (PE)	Uji i prodhuar	m ³	12,808,597	12,361,000	12,777,457	99.76%	103.37%	TP
	Uji i humbur	m ³	8,692,689	7,361,125	8,676,721	99.82%	117.87%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	4,115,908	4,999,875	4,100,736	99.63%	82.02%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	41,494	40,862	41,536	100.10%	101.65%	R
Mitrovica (MIT)	Uji i prodhuar	m ³	11,259,353	11,437,000	12,054,768	107.06%	105.40%	TP
	Uji i humbur	m ³	6,438,329	5,750,557	7,533,952	117.02%	131.01%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	4,821,024	5,686,444	4,520,816	93.77%	79.50%	Jo e R
	Faturimi-Jug	m ³	2,300,819	3,346,694	2,340,155	101.71%	69.92%	Jo e R
	Faturimi-Veri	m ³	2,520,205	2,339,750	2,180,661	86.53%	93.20%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	25,011	26,108	26,030	104.08%	99.70%	R
Radoniqi (GJA)	Uji i prodhuar	m ³	6,900,878	7,233,386	7,386,187	107.03%	102.11%	TP
	Uji i humbur	m ³	3,521,429	3,474,774	3,505,805	99.56%	100.89%	R
	Uji i faturuar	m ³	3,379,449	3,758,612	3,880,382	114.82%	103.24%	TP
	Konsumatorët	Nr	31,501	30,491	33,540	106.47%	110.00%	TP
Bifurkacioni (FE)	Uji i prodhuar	m ³	3,771,875	3,820,459	3,600,255	95.45%	94.24%	P
	Uji i humbur	m ³	2,005,320	1,763,109	1,887,968	94.15%	107.08%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	1,766,555	2,057,350	1,712,288	96.93%	83.23%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	22,936	23,746	24,247	105.71%	102.11%	TP
Hidromorava (GJI)	Uji i prodhuar	m ³	3,964,822	3,856,980	4,000,007	100.89%	103.71%	TP
	Uji i humbur	m ³	2,348,832	1,868,500	2,324,080	98.95%	124.38%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	1,615,990	1,988,480	1,675,927	103.71%	84.28%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	22,605	23,691	23,904	105.75%	100.90%	R
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	67,379,878	71,492,393	70,356,506	104.42%	98.41%	R
	Uji i humbur	m ³	38,162,361	35,754,969	40,348,405	105.73%	112.85%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	29,217,517	35,737,424	30,008,101	102.71%	83.97%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	295,372	301,320	309,579	104.81%	102.74%	TP


1.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënrat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krasimin vizual të të dhënavë historike për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 me të dhënrat e aprovuara nga ARRU dhe të dhënrat e realizuara nga KRU-të për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016.


Uji i prodhuar në m³




Uji i humbur në m³



Uji i faturuar në m³



Konsumatorët



Nga tabela numër 1 vërejmë se në baza sektoriale në dy nga katër treguesit e paraqitur KRU janë mirë krahasuar me të dhënat e provuara edhe atë te sasia e ujit të prodhuar, ku prodhimi në total i është përafruar sasisë së prodhimit të aprovuar nga ARRU dhe te numri i konsumatorëve, ku numri i konsumatorëve në total tejkalon numrin e aprovuar nga ARRU. Të dhënat për ujin e faturuar dhe humbjet e ujit në nive të sektorit nuk kanë arritur të realizojnë pritet të cilat janë aprovuar nga rregulatori. Për tu dalluar vlen të përmendet KRU Radoniqi e cila ka arritur të realizoj respektivisht përafroj të dhënat e realizuara me ato të aprovuarpër të gjithë treguesit e paraqitur.

2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifor 2015-2017, ARRU ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdeshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pasur shpenzime operative mbi kostot optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsy kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative të KRU-ve të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregulator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të zeza, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e llimit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregulator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ARRU (www.arru-rks.org).

2. 1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza


Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza për secilën KRU dhe sektorin, duke i paraqitur edhe shpenzimet operative historike për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, ato të aprovuara nga ARRU si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2016, të cilat janë vlerësuar me shkallën e përbushjes së caqeve në % dhe me vlerësimin tonë përfundimtar për këtë periudhë kohore.

Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €

Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Valuta	Historike 6m 2015	Aprovuara nga ARRU 6m 2016	Realizuara nga KRU 6m 2016	% Krahasuese viteve 6m2015/6m2016	% e realizmit të cakut 6m 2016	Vlerësimi përfundimtar për 6m 2016
Prishtina (PR)	Ujë	€	3,938,150	3,735,528	3,951,634	100.34%	105.79%	P
	Ujëra të Zeza	€	120,360	274,206	121,014	100.54%	44.13%	TP
	Totali	€	4,058,510	4,009,734	4,072,648	100.35%	101.57%	R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,394,779	1,535,500	1,329,025	95.29%	86.55%	TP
	Ujëra të Zeza	€	193,014	106,845	140,214	72.64%	131.23%	Jo e R
	Totali	€	1,587,793	1,642,344	1,469,239	92.53%	89.46%	TP
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,002,194	1,017,415	1,024,218	102.20%	100.67%	R
	Ujëra të Zeza	€	26,555	67,300	50,240	189.19%	74.65%	TP
	Totali	€	1,028,749	1,084,715	1,074,458	104.44%	99.05%	R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	1,002,081	1,053,784	994,782	99.27%	94.40%	TP
	Ujëra të Zeza	€	161,947	116,143	172,147	106.30%	148.22%	Jo e R
	Totali	€	1,164,028	1,169,927	1,166,929	100.25%	99.74%	R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,261,513	1,075,443	1,257,916	99.71%	116.97%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	46,889	130,230	47,831	102.01%	36.73%	TP
	Totali	€	1,308,402	1,205,673	1,305,747	99.80%	108.30%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	506,724	549,029	608,048	120.00%	110.75%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	118,464	95,814	163,600	138.10%	170.75%	Jo e R
	Totali	€	625,188	644,843	771,648	123.43%	119.66%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	653,193	569,320	680,454	104.17%	119.52%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	65,191	53,077	68,306	104.78%	128.69%	Jo e R
	Totali	€	718,384	622,397	748,760	104.23%	120.30%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	9,758,634	9,536,018	9,846,077	100.90%	103.25%	P
	Ujëra të Zeza	€	732,420	843,615	763,352	104.22%	90.49%	TP
Totali i përgjithshëm sektorial		€	10,491,054	10,927,823	10,609,429	101.13%	97.09%	TP


Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, 92.80% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 7.20% janë shpenzime të ujërave të zeza. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 është 10,609,429€, të cilat si të tillë janë brenda kufinjëve që ka përcaktuar ARRU.

Pjesmarrja e shpenzimeve nga uji dhe ujërat e zeza




2.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza


Shpenzimet operative për ujë



Shpenzimet operative për kanalizim



Përqindja e realizimit të shpenzimeve operative nga KRU-të



3. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për kahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga secila kompani në veçanti dhe sektorit në përgjithësi, në të cilat hynë të dhënat historike të realizuara për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, pastaj të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe ato të realizuara nga KRU-të gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2016, sipas procesit rregullatorë të përcaktimit të tarifave të viteve 2015-2017.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten të dhënat e aprovuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar për vitin 2016 dhe për kahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë të njëjtës periudhë të këtij viti me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2015.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ARRU në Mars të vitit 2014, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetrike për ujë i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim atribuohet si e vetme për shërbimin e ujërave të zeza.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe ato për ujëra të zeza, ARRU ka qenë e detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi i cili është konsideruar si më i arsyeshmi, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ARRU-KRU dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektorit të cilit i takojnë.

Shënim:

Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit (subvencione), që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ARRU-ës të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.

3.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza


Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016.

Tabela Nr. 3 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të zeza në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Të dhënët e faturimit për:	Valuta	Historike 6m 2015	Aprovuara nga ARRU 6m 2016	Realizuara nga KRU 6m 2016	% Krahas. 6m2015/6m2016	% e real. të cakut 6m 2016	Vlerësi mi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	5,718,228	6,901,746	6,082,512	106.37%	88.13%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	562,205	673,147	596,211	106.05%	88.57%	Jo e R
	Totali	€	6,280,433	7,574,894	6,678,723	106.34%	88.17%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,758,982	2,300,393	1,782,275	101.32%	77.48%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	211,037	261,118	213,341	101.09%	81.70%	Jo e R
	Totali	€	1,970,019	2,561,512	1,995,616	101.30%	77.91%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,501,142	1,710,600	1,508,121	100.46%	88.16%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	150,287	167,780	154,405	102.74%	92.03%	Jo e R
	Totali	€	1,651,428	1,878,380	1,662,526	100.67%	88.51%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë-Jugu	€	1,091,175	1,536,008	1,063,324	97.45%	69.23%	Jo e R
	Ujë-Veriu	€	428,557	397,866	370,784	86.52%	93.19%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	220,719	276,456	221,589	100.39%	80.15%	Jo e R
	Totali ¹	€	1,311,894	1,812,464	1,284,913	97.94%	70.89%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,562,806	1,743,849	1,565,584	100.18%	89.78%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	240,142	233,018	249,426	103.87%	107.04%	TP
	Totali	€	1,802,948	1,976,868	1,815,010	100.67%	91.81%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	887,043	929,673	797,046	89.85%	85.73%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	218,485	277,332	223,073	102.10%	80.44%	Jo e R
	Totali	€	1,105,528	1,207,005	1,020,119	92.27%	84.52%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	753,965	903,006	787,640	104.47%	87.22%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	132,748	136,594	144,569	108.90%	105.84%	TP
	Totali	€	886,713	1,039,601	932,208	105.13%	89.67%	Jo e R
Të dhënët sektoriale	Ujë	€	13,701,898	16,423,143	13,957,287	101.86%	84.99%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,735,622	2,025,447	1,802,614	103.86%	89.00%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	15,437,520	18,448,589	15,759,900	102.09%	85.43%	Jo e R

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë për këtë periudhë kohore, 88.56 % të shumës së faturimit në vlerë financiare realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 11.44% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 është realizuar faturimi në vlerë prej 15,759,900€, e që paraqet 85.43% të shumës së aprovar nga procesi rregulator për këtë periudhë kohore.


Pjesmarrja e faturimit nga uji dhe ujërat e zeza




¹ Në këtë pikë, totali nuk përmban edhe sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Por, për të qenë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturara për atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.

3.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza


Faturimi për ujë në euro



Faturimi për ujëra të zeza në euro



Përqindja e realizimit të faturimit në Euro



3.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza


Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016.

Tabela Nr. 4 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Arkëtimi për shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 6m 2015	Aprovuara nga ARRU 6m 2016	Realizuara nga KRU 6m 2016	% krahasuese 6m2015/6m2014	% e real. të cakut 6m2015	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	4,003,424	5,528,556	5,001,230	124.92%	90.46%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	420,768	544,812	524,382	124.62%	96.25%	P
	Totali	€	4,424,192	6,073,367	5,525,611	124.90%	90.98%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,217,049	1,834,454	1,351,301	111.03%	73.66%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	145,963	210,794	161,779	110.84%	76.75%	Jo e R
	Totali	€	1,363,012	2,045,248	1,513,080	111.01%	73.98%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	941,943	1,318,383	1,092,228	115.95%	82.85%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	94,315	134,379	111,825	118.57%	83.22%	Jo e R
	Totali	€	1,036,258	1,452,761	1,204,053	116.19%	82.88%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	546,364	1,016,070	619,224	113.34%	60.94%	Jo e R
	Subvencionet	€	173,698	247,261	130,000	74.84%	52.58%	Jo e R
	Ujërat e zeza	€	94,429	193,329	104,498	110.66%	54.05%	Jo e R
	Totali ²	€	640,792	1,209,399	723,722	112.94%	59.84%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,149,509	1,358,485	1,383,427	120.35%	101.84%	R
	Ujëra të Zeza	€	176,283	184,230	222,135	126.01%	120.58%	T P
	Totali	€	1,325,792	1,542,715	1,605,562	121.10%	104.07%	T P
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	472,496	672,516	554,641	117.39%	82.47%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	116,805	202,636	155,230	132.90%	76.61%	Jo e R
	Totali	€	589,301	875,153	709,871	120.46%	81.11%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	518,893	710,518	567,402	109.35%	79.86%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	91,388	108,227	119,883	131.18%	110.77%	T P
	Totali	€	610,281	818,745	687,285	112.62%	83.94%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	8,849,677	12,438,982	10,569,452	119.43%	84.97%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,139,952	1,578,407	1,399,732	122.79%	88.68%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	9,989,628	14,017,388	11,969,184	119.82%	85.39%	Jo e R

Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ARRU-së për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, 88.31% e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 11.69% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total, gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2016 është realizuar arkëtimi në vlerë prej 11,969,184€, e që paraqet 85.39 % të shumës së aprovar gjatë procesit tarifor 2015-2017, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016.


Pjesmarrja e arkëtimit nga uji dhe ujërat e zeza




² Subvencionet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar kostot e ujit të trajtuar me shumicë për pjesën veriore të Qytetit të Mitrovicës, nuk përbëjnë totalin në këtë pikë, por ato janë vendosur vetëm si shifër ilustrative për të informuar palët e interesit.

3.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza


Arkëtimi për ujë në euro



Arkëtimi për ujëra të zeza në euro



Përqindja e realizimit të arkëtimit në Euro



Sic edhe vërehet nga diagrami, e vetmja KRU e cila ka realizuar dhe tejkaluar cakun e arkëtimit është KRU “Radoniqi” Gjakovë për çka meriton të komplimentohet. Vlen të përmendet edhe angazhimi i KRU “Prishtina” që ka përbush këtë cak në masën prej 91%.

4. INVESTIMET KAPITALE

Me aprovinin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2015-2017, ARRU-KRU kanë planifikuar realizimin e shumave të caktuara të investimeve, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit** dhe **shërbimet e kanalizimit**, të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznisore.

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të zeza janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznisore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asete të infrastrukturës** dhe **ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** më tutje janë të ndara në investime: (i) të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, (ii) dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: (i) fabrikat për trajtimin e ujit, (ii) ndërtesat administrative, (iii) mjetet transportuese, (iv) pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të ARRU.

4.1. Shumat e investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016. Më këtë bëhet kahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ARRU me ato të realizuara nga KRU-të për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtar.

Tabela Nr. 5. Shumat e investimeve kapitale për ujë te financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 shprehur në €

Emri i kompanisë	Kategori të Investimeve	Aprovuara 6m 2015	Realizuara 6m 2015	% e real. të cakut 6m 2016	Vlerësimi përfundimtar
PRISHTINA	Resurse dhe trajtimi i	887,737	1,238,969	139.56%	TP
	Distribuim	382,241	109,818	28.73%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	510,196	63,856	12.52%	Jo e R
	Totali	1,780,174	1,412,643	79.35%	Jo e R
Hidroregioni-Jugor	Resurse dhe trajtimi i	61,418	0	0.00%	Jo e R
	Distribuim	97,370	3,527	3.62%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	7,948	470	5.91%	Jo e R
	Totali	166,737	3,997	2.40%	Jo e R
Hidrodrini	Resurse dhe trajtimi i	7,490	0	0.00%	Jo e R
	Distribuim	191,994	0	0.00%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	19,973	0	0.00%	Jo e R
	Totali	219,458	0	0.00%	Jo e R
Mitrovica	Resurse dhe trajtimi i	0	0	!	E pa K
	Distribuim	0	0	!	E pa K
	Aktivitetet biznesore	0	0	!	E pa K
	Totali	0	0	!	E pa K
Radoniqi	Resurse dhe trajtimi i	149,801	10,508	7.01%	Jo e R
	Distribuim	54,927	65,510	119.27%	TP
	Aktivitetet biznesore	32,207	29,732	92.32%	Jo e R
	Totali	236,935	105,751	44.63%	Jo e R
Bifurkacioni	Resurse dhe trajtimi i	67,410	12,154	18.03%	Jo e R
	Distribuim	66,412	3,664	5.52%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	2,497	690	27.64%	Jo e R
	Totali	136,319	16,509	12.11%	Jo e R
Hidromorava	Resurse dhe trajtimi i	9,987	6,585	65.93%	Jo e R
	Distribuim	2,497	9,470	379.30%	TP
	Aktivitetet biznesore	0	683	!	E pa K
	Totali	12,483	16,738	134.08%	TP
Sektori	Resurse dhe trajtimi i	1,183,843	1,268,216	107.13%	TP
	Distribuim	795,441	191,990	24.14%	Jo e R
	Aktivitetet biznesore	572,822	95,431	16.66%	Jo e R
	Totali	2,552,105	1,554,668	60.92%	Jo e R

Tabela Nr. 6. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza te financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 shprehur në €

Emri i kompanisë	Kategori të Investimeve	Aprovuara 6m 2016	Realizuara 6m 2016	% e real. të cakut	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina	Grumbullimi i u.z	141,187	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	0	1,975	!	E pa K
	Totali	141,187	1,975	1.40%	Jo e R
Hidroregjioni-Jugor	Grumbullimi i u.z	55,426	387	0.70%	Jo e R
	Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	0	0	!	E pa K
	Totali	55,426	387	0.70%	Jo e R
Hidrodrini	Grumbullimi i u.z	52,430	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
	Aktivitete biznesore	72,404	0	0.00%	Jo e R
	Totali	124,834	0	0.00%	Jo e R
Mitrovica	Grumbullimi i u.z	37,450	0	0.00%	Jo e R
	Trajtim i u.z	0	0	!	E pa K
	Trajtimi i llumit	0	0	!	E pa K
